

# RAPORT

## I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit Master i Shkencave ne Stomatologji

Ofruar nga Albanian University

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dr. Ramazan Isufi  
Prof. Asoc. Çeljana Toti



(Korrik, 2017)

## **RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

### **Për Programin e studimit MSc në Stomatologji**

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Albania University
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Mjekësore
3	Urdhëri/VKM i licencimit Urdhëri/VKM I riorganizimit	VKM Nr 197, dt 10.04.2004 (4 vjet kohëzgjatja e Msc) Urdhër nr 197, dt 07.04.2010 (riorganizimi nga 4 vite në 5 vite akademike me 300 ECTS)
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	UMAS Nr 388, dt 23.07.2010
5	Titulli i programit të studimit:	Msc në Stomatologji
6	Cikli i studimit:	Cikli I dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	5 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	300 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7 (shtatë)
16	Aktivizimi i programit të studimit me 5 vite akademike	2009-2010
17	Numri i studentëve aktualë	375 studentë
	etj	

## HYRJE

Programi i studimit në Stomatologji është miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, Nr. 197, dt.10/04/2004 me kohëzgjatje 4-vjeçare (8 semestra). Titulli i Diplomës që përfitonte studenti ishte “Mjek Stomatolog i Përgjithshëm”. Në vitin akademik 2009-2010, pas procedurës së Vlerësimit të Jashtëm nga APPAL u la si kusht akreditimi që të kalohej nga kohëzgjatja e studimit 4 vjeçar, për brezat aktiv, në kohëzgjatje 5 vjeçare. Kjo u bazua në vendimin nr.88, datë 16.07.2010 të Këshillit të Akreditimit, sipas se cilit, kohëzgjatja e studimeve për degën “Stomatologji” nuk mund të jetë më e vogël se 5 vjet. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, me Urdhër të Ministrit, me numër 388, datë 23/07/2012 vendosi që afati i studimit për diplomën e Stomatologjisë, të ndryshojë nga 4 në 5 vjet, në total jo më pak se 300 kredite. Që nga brezi 2009-2010 e deri tani ky program studimi shtrihet në 5 vite akademike dhe me një curricul prej 300 kredite në total. Kjo realizohet nga Departamenti i Stomatologjisë, pranë Fakultetit të Shkencave Mjekësore. Në përfundim të mbrojtjes së diplomës, studentëve u jepet grada “Master i Shkencave në Stomatologji” dhe titulli “Stomatolog”, për Republikën e Shqipërisë. GVJ perfundimisht ka vlerësuar Programin e Studimit “Master i Shkencave ne Stomatologji” ku ne kete raport pasqyrohen pershkrimet analitike te situates , treguesit e matshem dhe vleresimimi sipas standarteve per kategorite e percaktuara ne udhezuesin e veleresimit te jashtem , konkluzionet e arritura si dhe rekomandime lidhur me permiresimin e cilesise se mesimdhënies , ngritjen e strukturave dhe nivelit te kerkimit shkencor dhe per vitet ne vazhdim. GVJ organizoi disa takime per te realizuar procesin e vleresimit dhe ndarjen e detyrave midis anetareve te tij. Njekohesisht u organizuan takime dhe biseda me anetare te tjere te stafit te fakultetit , sekretarine mesimore si dhe Departamentin e Burimeve Njerezore per mbledhjen e informacionit te nevojshem dhe te sakte per te arritur procesin e Vleresimit te jashtem.

## GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof Dr. Ramazan Isufi
2. Prof. As Çeljana Toti

Grupi i vlerësimit të jashtëm u shoqërua në Institucion nga specialistja e ASCAL Znj Suela Kromidha.

Më datë 17.07.2017 me shkresë në 184/24 prot, dërgohet në Institucion Draft Raporti I Vlerësimit të jashtëm. Më datë 19.07.2017, Albanian University kthen pergjigje duke shprehur dakordësinë me këtë Draft raport. Në këtë mënyrë Drafti kthehet në Raport dhe firmoset nga Ekspertët e vlerësimit të jashtëm.

## ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

### I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

- a) Kalimi nga sistemi 4 vjeçar ne ate 5 vjeçar
- b) Rritja e kapaciteteve te infrastruktorore per pjesen klinike dhe profesionale
- c) Zvogelimi i numrit te studenteve neper grupet mesimore

### II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a) Për rekomandimin e parë institucioni e ka korrigjuar. Që nga brezi 2009-2010 të gjithë studentët kryejnë studim në degën e Stomatologjisë me një program që shtrihet në 5 vite
- b) Për rekomandimin e dytë institucioni ka ngritur Klinikën Universitare, pranë të cilës realizohen të gjitha praktikat mësimore me pacientë; nga 60 poltrona tani ka 84 poltrona; nga 3 salla pune tani janë 6 të tilla

- c) Për rekomandimin e tretë ka përmirësim. Grupet mësimore organizohen në një numër prej 18-22 studentësh

## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.


Programi i Studimit “Master i Shkencave në “Stomatologji” organizohet nga Departamenti i Stomatologjisë, i cili është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave Mjekësore. Ky program ishte projektuar për të ofruar formim të specializuar profesional, për të përgatitur individë të aftë për të ushtruar këtë profesion, por edhe për t’u përgatitur për role drejtuese dhe menaxhuese në sektorin publik dhe privat, brenda dhe jashtë vendit. Departamenti i Stomatologjisë ofronte diplomë të integruar të ciklit të dytë “Master i Shkencave në Stomatologji”, përveç edhe disa programeve të specializimit të miratuara nga MASH, me kohëzgjatje 3-4 vjeçar. Departamenti strukturohej mbi bazë katedrash: Katedra e Terapisë, Katedra e Dentistrisë Pediatrike, Katedra e Protetikës, Katedra e Kirurgjisë Orale dhe OMF, Katedra e Periodontologjisë. Ky program studimi kishte si objektiv kryesor formimin teorik dhe praktik të studentëve, bazuar kryesisht në modelin e Universitetit TUFT-s Boston dhe mbështetur totalisht në literaturën amerikane të këtij Universiteti. Mjeku stomatolog i formuar mbi këto kritere, do të jetë i aftë t’i bëjë ballë kërkesave gjithmonë në rritje dhe standardeve të BE, duke i rritur atij mundësinë të integrohet lehtësisht, ose të punojë si profesionist i lirë në klinika stomatologjike, në institucione publike, në sektorë promovues dhe prodhues të pajisjeve stomatologjike, në qendra kërkimore të profilit akademik, ose në hapësira të ndryshme akademike, brenda dhe jashtë Shqipërisë. Në vazhdimësi të këtyre objektivave është punuar në këtë institucion në përfshirjen e studentëve në punime shkencore duke stimuluar tek ata punën në grup si edhe shfrytëzimin e literaturës. Programi shtrihet në 5 vite akademike me 300 kredite sipas sistemit të Bolonjës dhe në përshtatje me standartet evropiane. Mësimdhënia dhe kërkimi shkencor realizoheshin duke integruar mësimin dhe kërkimin shkencor, duke e bërë këtë program të mundshëm për përgatitjen e mjekëve stomatologë për t’ju përgjigjur nevojave të tregut të punës.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	Mendojmë se programi i Studimit Master në Stomatologji është në përputhje me qëllimet e shkollës së lartë për plotësimin gjithnjë e në rritje të cilësisë ndaj shërbimit të pacientit. Nëpërmjet këtij Programi studimi mendojmë se rriten aftësitë intelektuale dhe profesionale të studentëve nëpërmjet një trajnimit cilësor. Ky program kishte objektiva të përcaktuara qartë
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
<b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	

<p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>si për formimin teorik ashtu dhe praktik të studentit. Programi i Studimit realizohet nga Departamenti i Stomatologjisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore. Në përfundim të mbrojtjes së diplomës, studentëve u jepej grada “Master i Shkencave në Stomatologji” dhe titulli “Stomatolog” për Republikën e Shqipërisë.</p> <p>Tregu i punës ka gjithmonë nevojë për mjek stomatolog të përgatitur si nga ana teorike ashtu edhe nga ajo praktike. Në ekonominë e tregut secili mund të tregojë vlerat e tij si profesionist. Mendojmë se studentët e diplomuar i përgjigjen nevojave të tregut të punës në Shqipëri</p> <p>Programi ishte hapur së pari në vitin 2004. Përgjatë viteve, programi kishte pësuar ndryshime, plotësime dhe përmirësime në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit në përgjithësi dhe këtij specialiteti në veçanti parashikuar sipas standarteve të kerkuara Programi në objektivat e tij parashikonte jo vetëm përgatitjen profesionale të studentëve, por edhe implementimin e vlerave njerëzore dhe humane të mjekëve të rinj. Ruajtja e vlerave kulturore të kombit mbështetet nga etika profesionale e transmetuar në shërbimin cilësor të ofruar ndaj pacientëve si edhe shërbimin falas për një kategori pacientësh në pamundësi ekonomike.</p> <p>Mendojmë se ky program është në përputhje me kornizën shqipëtare të kualifikimit.</p>
<p><b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Nga dokumentacioni i paraqitur, konstatohet se programi i studimit “Master i shkencave në Stomatologji”, është në përshtatje me strategjitë e institucionit. Mendojmë se ka akoma vend për të përmirësuar më shumë nivelin e mësimdhënies dhe mësimnxënies duke futur teknologji të reja, duke motivuar kërkimin shkencor si dhe duke rritur bashkëpunimin me institucione simotra brenda dhe jashtë vendit.</p>
<p><b>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqipëtare e Kualifikimit.</p>	<p>Kurrikulat e programit të studimit janë ndërtuar mbi bazën e Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) në përputhje të plotë dhe me Statutin e Universitetit dhe me Legjislacionin Shqiptar në Fuqi.</p> <p>Emërtimi i programit të studimit ishte i reformuar duke u bazuar në Ligjin Nr. 9741 datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në përfundim të studimeve lëshohet Diplomë e</p>

	<p>Albanian University dhe studenti pajisej me diplome "Master Shkencor në Stomatologji". Ky program studimi ishte hartuar në përputhje me qëllimin dhe misionin e këtij Universiteti</p>
<p><b>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Duke u shtyrë nga sygjërimet dhe detyrat e grupeve të kontrollit, institucioni kishte treguar kujdes për të reflektuar ndryshime pozitive në programin e studimit. Kjo kishte nisur me ndryshimin nga një kohëzgjatje 4 vjeçare në atë 5 vjeçare të programit të studimit duke respektuar 300 kredite në curriculën mësimore. Përmirësime janë vënë re edhe në infrastrukturën e institucionit duke krijuar kushte shumë të mira për praktikën mësimore me pacientët si edhe auditorë të kompletuara për zhvillimin e seminareve apo projekteve të ndryshme.</p> <p>Institucioni kishte hartuar një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit. Kjo reflektohej në angazhimin e stafit akademik në të qëndruarit në kontakt me të rejtat më të fundit të shkencës dhe përdorimin e futjen e këtyre njohurive në planprogramet e lëndëve përkatëse. Në shërbim të studentëve vihej literatura, shumica e të cilës e përkthyer në shqip. Praktika mësimore realizohej pranë Klinikës Universitare e cila ishte e pajisur me aparaturë moderne dhe e plotësuar me materiale cilësore. Klinika ofronte pacientë për studentët dhe prezencën në sallë e pedagogëve si edhe ordinateve, krijonte kushte jo vetëm për një punim cilësor të kontrolluar, por edhe mundësinë e diskutimit të rasteve të ndryshme klinike me problematikat përkatëse. Programi kishte parashikuar orë leksioni në auditor, seminare dhe praktika klinike. Aplikimin e tij e plotësonte me korrektësi Departamenti, si njësi që koordinonte mbarëvajtjen e procesit mësimor, në të gjitha aspektet e tij dhe komunikimin e vazhdueshëm me studentët dhe pedagogët, marrjen e feedback-ut për sa i përket procesit mësimor dhe procesit të të nxënit; me qëllim përmirësimin e tyre, kur shihej e nevojshme.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p>Duke parë elementet e mësipërm mund të arrijmë në konkluzionin se :</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Programi i studimit në Stomatologji ishte bazuar në vendimin nr.88, datë 16.07.2010 të Këshillit të Akreditimit, sipas se cilit, kohëzgjatja e studimeve për degën "Stomatologji" nuk mund të jetë më e vogël se 5 vjet. Ministria e Arsimit dhe Shkencës, me Urdhër të Ministrit, me numër 388, datë 23/07/2012 vendosi që afati i studimit për diplomën e Stomatologjisë, të ndryshojë nga 4 në 5 vjet, në total jo më pak se 300 kredite. Ky Program përputhet me standartet shtetërore.</li> <li>2. Programi i studimit kishte një ndërthurje të saktë midis lëndëve teorike dhe praktike që përputhej me standartet shtetërore.</li> </ol>	



3. Departamenti i Stomatologjisë si pjesë e Fakultetit të Shkencave Mjekësore kontrollonte dhe koordinonte këtë program si dhe ishte i organizuar në 5 Katedra.
4. Për secilën lëndë ishin përpiluar silabuset përkatëse të cilat përmirësoheshin në varësi të nevojave dhe zhvillimit të këtij programi studimi.
5. U konstatua një infrastrukturë e përshtatshme si edhe ambjentet e Klinikës Universitare të cilët viheshin në dispozicion të punës akademike dhe praktike me pacientët.
6. Literatura ishte e bollshme por sygjerojmë që të shfrytëzohet edhe literatura e autorëve shqiptarë.
7. Mendojmë se programi i plotëson standartet e kërkuara në këtë drejtim.

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Fakulteti i Shkencave Mjekësore është një strukturë e re e cila ishte krijuar nga riorganizimi institucional me urdher numër 52 datë 05.02.2016. Por me emrin e Fakultetit të Stomatologjisë ka rreth 13 vite që operon në tregun e arsimit të lartë privat. Për arritjen e këtij qëllimi ishte organizuar personel akademik efektiv (PAE), personel akademik me kontratë (PAK) si dhe personel administrativ (PA). Personeli akademik i programit të studimit përbëhej vetëm nga pedagogë shqiptarë. Përgjegjësi i Departamentit në fund të çdo viti akademik vlerësonte nevojën e rekrutimit të pedagogëve të jashtëm. Për këtë zhvillohej një konkurs me dosje dhe nënshkruhej kontrata për fituesit. Nga ana tjetër Përgjegjësi i departamentit nxiste edhe aktivitetin shkencor të anëtarëve efektive duke përditësuar aktivitetin e tyre shkencor. Të dhënat mbi aktivitetin shkencor të stafit ndodheshin pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore ishte njësi kryesore që bashkërendonte mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor në fusha mësimore - kërkimore, të përafërta ose të ndërthurura, të njëjësive bazë. Struktura organizative e Fakultetit përbëhej nga autoritetet drejtuese, organet drejtuese, njësitë bazë të punës mësimore - shkencore dhe nga administrata. Autoritetet drejtuese janë Dekani, Zëvendës/Dekani dhe Drejtuesit e Departamenteve. Organi drejtues është Këshilli i Fakultetit të Shkencave Mjekësore. Rregullorja e Fakultetit, Përcaktonte Përberjen dhe funksionin e këtyre strukturave.

Këshilli i Fakultetit të Shkencave Mjekësore ishte organ drejtues kolegjal vendimmarrës, i cili kryesohej nga Dekani. Ai përbëhej nga anëtarë të stafit akademik, administrativ dhe studentë.

Dekani i Fakultetit të Shkencave Mjekësore ishte autoriteti më i lartë drejtues dhe përfaqësues i Fakultetit. Emërohej në detyrë nga Administratori (të cilit i ishte njohur kjo Kompetencë në kontratë), me propozimin e Senatit Akademik, për një mandat 4 vjeçar, me të drejtë rrimërimi. Dekani duhej të kishte të paktën titullin "Profesor i Asociuar", ose gradën shkencore "Doktor" të fituar pranë universiteteve Përfundimtare. Kompetencat dhe detyrat e Dekanit përcaktoheshin në Rregulloren e Fakultetit.

Fakulteti kishte dy Zëvendës/Dekanë, Zëvendës/Dekani për procesin mësimor dhe Zëvendës/Dekani për Kërkimin Shkencor. Zëvendës/Dekani emërohej dhe shkarkohej nga Administratori (të cilit i ishte njohur kjo Kompetencë në kontratë), me propozim të Dekanit dhe me pëlqimin e Rektorit, për një mandat 4 vjeçar, me të drejtë rrimërimi. Ai

duhej të kishte së paku gradën shkencore "Doktor Shkencash". Detyrat e tyre përcaktoheshin në Rregulloren e Fakultetit.

Programi "Master i Shkencave në Stomatologji" përfshihej në një nga departamentet e Fakultetit të Shkencave Mjekesore, pikërisht nga Departamenti i Stomatologjisë.

Drejtuesi i Departamentit ishte autoriteti më i lartë për këtë njësi. Ai drejtonte, organizonte dhe përgjigjej për punën mësimore dhe kërkimore-shkencore në njësinë bazë dhe i raportonte Dekanit. Përgjegjësi i njësisë bazë propozohej nga Senati Akademik dhe emërohej nga Administratori. Kompetencat e Përgjegjësit të Departamentit përcaktoheshin në Rregulloren e Fakultetit.

Mendojme se organigrama e Fakultetit është në përputhje me standartet shtetërore

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit

Këshilli i Fakultetit të Shkencave Mjekësore ishte organi drejtues kolegjal vendimmarrës, i cili kryesohej nga Dekani Dr.Shk.Med. Erda Qorri. Ai përbëhej nga anëtarë të stafit akademik, administrativ dhe studentë.

Drejtuesi më i lartë i Fakultetit të Shkencave Mjekësore ishte Dekani, i cili propozohej nga Senati dhe emërohej nga Administratori. Pas Dekanit ishin dy ZV/Dekanë, njeri për anën mësimore dhe tjetri për anën e kërkimit shkencor. Fakulteti organizohej në departamente. Departamenti i Stomatologjisë, Departamenti i Farmacisë dhe Departamenti i Infermerisë dhe Fizioterapisë. Drejtuesi më i lartë i kësaj njësie (departamentit) ishte përgjegjësi i departamentit Dr.Shk.Elona Kongo.

Departamenti ishte i organizuar në katedra ku për çdo lëndë ishin edhe titullarët e lëndës.

- Organët e zgjedhura në të gjitha nivelet. Zgjedhje e posteve drejtuese realizoheshin duke zbatuar rregulloren e brendshme të universitetit.

<b>Standardi/Kriteret</b>	<b>Vlerësimi sipas standardeve</b>
<b>Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;	Albanian University ka krijuar një infrastrukturë të përshtatshme për të përmbushur misionin e tij. Organizimi strukturor ishte në përputhje me ligjin dhe rregullohej, kontrollohej nga Rregullorja e Universitetit Albanian University ka 3 Fakultete: Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike si dhe Fakulteti i Shkencave Shoqërore. Secili prej fakulteteve është i organizuar në të paktën 3 Njësi Bazë. Fakulteti i Shkencave Mjekësore ka në përbërje të tij 3 Departamente; Departamenti i Stomatologjisë, Departamenti i Farmacisë dhe Departamenti i Infermerisë dhe Fizioterapisë. Nga tabelat e përditësuara të vitit akademik 2016-2017, Departamenti i Stomatologjisë kishte në përbërjen e tij 45 pedagogë efektiv ndër të cilët 4 me titullin "Profesor", 3 me titullin akademik
<b>Kriteri 2</b> Institucioni ka së paku dy Fakultete;	
<b>Kriteri 3</b> Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;	
<b>Kriteri 4</b> Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;	
<b>Kriteri 5</b> Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si Përsonele akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".	



	“Profesor i asociuar”, 17 Doktor Shkencash dhe pjesa tjetër Msc. ose në proces doktorature.
<b>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;	Departamenti i Stomatologjisë ishte i ndërgjegjshëm për Përgjegjësitë në realizimin e programit dhe Përbushjen e misionit. Ai mbante nën kontroll dhe koordinonte si anën mësimore ashtu edhe pjesën klinike duke u përpjekur që të mos kishte mangësi si për stafin ashtu edhe për studentët.
<b>Kriteri 2</b> Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të Përsoneelit akademik të nëvojshëm dhe në vlerësimin e tij.	Njësitë bazë dhe kryesore përfshiheshin në procesin e rekrutimit dhe përzgjedhjes, duke respektuar procedurat e brendshme të rekrutimit sipas Rregullores së Universitetit
<b>Konkluzionët e vlerësimit:</b> Nga vizita në institucion u konstatua se:	
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Për sa i përket organigramës të Fakultetit të Shkencave Mjekësore dhe vecanërisht të Departamentit të Stomatologjisë ai përbëhej nga një staf akademik i plotë me tituj dhe grada shkencore pa përjashtuar dhe stafin e mjaftueshëm administrativ.</li> <li>2. Në dispozicion të programit ishte vënë një infrastrukturë e bollshme, komode, e pajisur në mënyrë bashkëkohore, me auditore dhe salla klinike moderne.</li> <li>3. Organizimi institucional ishte në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi si edhe në respektim të rregullores së AU. Secila njësi ishte e ndërgjegjshme për detyrat nëpërbushjen e misionit të saj.</li> </ol>	

### 3. Përsoneeli akademik dhe Përsoneeli mbështetës për programin e studimit

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Përsoneelit akademik, ndarja e tij në Përsoneel Akademik Efektiv (PAE) dhe Përsoneel Akademik me Kontratë (PAK), Përsoneel Administrativ (PA), raportet PAE/PAK, raportet: Përsoneel akademik/Përsoneel administrativ/student; nëvojat për Përsoneel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për Përsoneelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të Përsoneelit akademik, etj.

Personeli akademik dhe administrative u pa se njihnte objektivat e programit të studimit dhe këtë punë e bazonte mbi këto objektiva.

Gjithashtu ne konstatuam se personeli ndihmës akademik si dhe mësimor shkencor apo administrativ angazhohej në realizimin e këtij program studimi.

Personeli akademik i brendshëm ishte i mjaftueshëm për realizimin e këtij programi si dhe me gradat apo titujt përkatës.

U konstatua se procedurat ligjore për rekrutimin e personelit kryheshin në bazë të standarteve shtetërore.

Stafi i mësimdhënies përbëhej nga pedagogë Shqipëtarë të cilët ishin me kontrata pune të rregullta të lidhura me institucionin.

Nga ana tjetër në fund të cdo viti akademik, Departamenti i Stomatologjisë bënte një parashikim të ngarkesës mësimore dhe i dërgonte shkresë të protokolluar Këshillit të

Fakultetit të Shkencave Mjekësore, mbi vendet vakante dhe plotësimin e stafit akademik aktual.

Personeli akademik efektiv mbulonte 70% të ngarkesës në orë mësimore. Drejtuesi dhe Asistentët e Departamentit, në bashkëpunim me Dekanin e Fakultetit, merreshin me anën administrative dhe organizative të procesit didaktik dhe shkencor. Procesi mësimor realizohej me suportin e vazhdueshëm të administratorëve të godinave, të sekretarive mësimore dhe kryesekretares.

Dosja e Pedagogut përmbante: Curriculum Vitae të pedagogut, fotokopje të noterizuar të diplomës së shkollës së lartë, fotokopje të noterizuar të listës së notave, fotokopje të noterizuar të titujve (Master, PhD), fotokopje të noterizuar të kualifikimeve të tjera (në rast se ka), nga punëdhënësi, fotokopje të librezës së kontributeve shoqërore dhe shëndetësore, Librezë shëndetësore dhe raport mjekësor, që vërtetonte që Përsoni është i aftë për punë.

Te gjitha keto ishin ne baze te standarteve shteterore.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Struktura didaktike (seksionët) për departamentet ose programin e studimit

Departamenti i Stomatologjise strukturohej mbi bazë katedrash:

- Katedra e Terapisë me lëndët: dentistri paraklinike dhe klinike, endodonti paraklinike dhe klinike, dentistri estetike
- Katerdra e Dentistrisë Pediatrike me lëndët: dentistri pediatrike, profilaksi, nutricion
- Katedra e Protetikës me lëndët: morfologji dentare, njohuri materiale, protetike paraklionike, protetike e levizshme parciale, protetike totale, ortodobt paraklinike dhe klinike
- Katedra e Kirurgjisë Orale dhe OMF me lëndët: anestezi, kirurgji orale, kirurgji OMF, mjekesi orale
- Katedra e Periodontologjise me lëndët: Përiodontologji paraklinike dhe klinike, diagnoze orale, patologji OMF, implantologji, radiografia orale.
- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK) Aneksi 1 dhe Aneksi 2
- Këshilli Shkencor i Programit të studimit Aneksi 3
- Të dhënat sipas kualifikimit dhe raportet PAE/ PAK Aneksi 4
- Të dhënat sipas seksit

<b>Femra PAE</b>	<b>Meshkuj PAE</b>	<b>Raporti F/M (PAE)</b>	<b>Femra PAK</b>	<b>Meshkuj PAK</b>	<b>Raporti F/M (PAK)</b>
33	12	2.75	14	10	1.4

- Të dhëna sipas moshës së Personelit (Tabela 8), (Tabela 9)
- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

I gjithë Përsoneli i përfshirë në program, në cdo fillim viti akademik, nënshruante kontratën e punës, e cila depozitohej në Zyren e Burimeve Njerezore. Personeli njihej me të drejtat dhe detyrimet në varësi të orëve që do të mbulonte. Pagesat administroheshin në varësi të

ngarkesës akademike apo administrative të secilit. Gjate vizites sone konstatuam se numri i personelit akademik efektiv dhe me kontrate ishte ne perputhje me standartet akademike.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë .

Nga të dhënat e marra në institucion, rezultoi se stafi administrativ dhe ai ndihmës mësimor përbehej nga 45 Persona, nga të cilët: 2 as. Departamenti; 2 IT; 8 laborante; 7as.klinike; 9 as.pedagog; 1 radiolog; 2 sekretare; 2 receptioniste; 1 magaziniere; 1 teknik; 1 Përsoneel në biblioteke; 1 në librari; 1 teknik; 1 higjenist; 1 punëtor mirembajtjeje; 4 ordinate; 1 kancelar dhe 1 kryesekretar. (Tabela 10)

**Vlerësimi sipas Standardeve**

<b>Standardi/Kriteret</b>	<b>Vlerësimi sipas standardeve</b>
<b>Standardi II.1 - Përsoneeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përsoneeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Përsoneeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Personeli akademik, ndihmës dhe mësimor-shkencor angazhohej në mënyrë aktive për arritjen e objektivave të programit të studimit në Stomatologji, duke vënë në dispozicion materiale shitesë për studentët, në realizimin e konsultave të përditshme nëndjekjen e procesit të trajnimit të tyre në sallat e klinikës universitare, nëpërcjelljen e informacionëve te ndryshme, organizimin e provimeve, përditesimin e faqes se internetit, etj. Për sa i përket performancës ajo kontrollohej nga Zyra e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila angazhohej dhe bënte herë pas here rekomandimet e nevojshme për të përmirësuar këto objektiva në bazë të standarteve të kërkuara.</p> <p>Personeli I përfshirë në program njihej me të drejtat dhe detyrimet në përmbushjen e misionit të institucionit. Secili duhet të përmbushte detyrimet dhe të kordinonte punën me instancat e tjera në përputhje me strategjitë e zhvillimit të programit</p>
<b>Standardi II.4 - Përsoneeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Rekrutimi i Përsoneelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Departamenti përfshinte personelin akademik efektiv në Përpilimin e programit të studimit. Titullarët e lëndëve ishin përgjegjës për syllabuset dhe në mbledhjet që departamenti organizonte, realizoheshin debate dhe diskutime të hapura me qëllim përmirësimin e punës.</p> <p>Rekrutimi i Personelit të ri bëhej me konkurs dhe me një procedurë transparente. Institucioni në varësi edhe të specifikave të programit bënte një shpërndarje të kujdesshme të ngarkesës mësimore, ku pjesën më të madhe të ngarkesës e mbanin pedagogët efektivë.</p>
<b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e Përsoneelit.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e Përsoneilit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Përsoneili akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të Përsoneilit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të Përsoneilit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të Përsoneilit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Procedura e rekrutimit të Personelit ishte transparente dhe në përputhje me Rregulloren dhe Statutin e Universitetit.</p> <p>Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programin e studimit në Stomatologji përbënte afërsisht 70% të Personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit. Duke krahasuar tabelat e vitit akademik 2015-2016 me atë të vitit akademik 2016-2017, vihej re një përmirësim i ndjeshëm në këtë raport, duke treguar impenjimin e institucionit në Përmirësimin e detyrimeve ligjore. Ne konstatuam se personeli akademik nuk plotësohej me ngarkesën sipas titujve perkates.</p> <p>Personeli i angazhuar vlerësohej duke ndjekur dhe zbatuar me rigorozitet procedurat transparente dhe ligjore. Herë pas here organizohej shpërndarja e pyetësorëve nëpërmjet të cilëve, stafi akademik njihej me këto vlerësime.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore mbante një bazë të dhënash të përditësuara me të gjitha ndryshimet e nevojshme dhe eventuale të të dhenave</p>
<p><b>Standardi III.2 - Përsoneili akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve Përfundimtare dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni siguron Përsoneil të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Programi i studimit në Stomatologji plotëson kriteret e nevojshme për sa i përket titujve akademike apo shkencore të drejtuesve dhe stafit perkates. Përgjegjësi i programit ka titullin “Doktor” në fushën e stomatologjisë, të fituar jashtë shtetit përkundrajt standarteve të kerkuara Lëndët e përfshira në kurrikul mbulohehin nga titullarë me gradën “Prof.Dr”; “Prof. As” dhe “Doktor”.</p> <p>Të gjitha figurat drejtuese të Universitetit, Fakultetit kishin titujt e nevojshëm të përcaktuar në Ligj, dhe ishin të punësuar me kohë të plotë.</p> <p>Institucioni kishte venë në dispozicion të programit një numër të konsiderueshëm Personeli, i cili mbikëqyrte dhe kontrollonte praktikën profesionale. Asnjë punim me pacientët nuk kalonte i pa kontrolluar nga stafi i institucionit ku përfshiheshin pedagogët, as/pedagogët apo ordinatorët e sallave. Kontrolli i Personelit akademik siguronte cilësinë e protokollit si edhe ishte Përgjegjës për organizimin e vazhdimësisë së trajtimeve dentare të kryera në Klinikën Universitare nga studentët</p>
<p><b>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p>	<p>Duke nisur nga viti akademik 2015-2016, ishte realizuar provimi i diplomës me mbrojtjen e një teze kërkimore-shkencore. Duke patur parasysh vecoritë e programit, kjo mundësi u ishte dhënë studentëve me cilësori me një mesatare të lartë.</p>

<p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humanë.</p>	<p>Shpërndarja e temës bëhej që në fillim të vitit akademik në mënyrë që studenti të ketë kohën e mjaftueshme për të realizuar temën e diplomës. Mendojmë se dhënia e temës së diplomës duhet planifikuar që në fillim të vitit të katërt dhe jo në fillim të vitit të pestë për të bërë tema sa më cilësore. Cdo student ka udhëheqësin e temës. Personeli akademik i cili kishte të paktën gradën shkencore “Doktor”, vihej në dispozicionin e studentëve për udhëheqje të temës së diplomës. Udhëheqësi, në programin e studimit në fushën e stomatologjisë, nuk drejtonte më shumë se 5 studentë njëkohësisht, duke plotësuar gjithnjë standardin e kërkuar. Ai ishte Përgjegjës për ndjekjen e punës se kryer duke e ndihmuar dhe udhëhequr studentin.</p>
<p><b>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Katedrat e Departamentit të Stomatologjisë paraqesin temat specifike në fillim të vitit akademik, shoqëruar me udhëheqësin përkatës, i cili ishte i aftë të mbulonte përmbajtjen e temës të përzgjedhur të katedrës, me njohuritë e avancuara teorike dhe aftësitë kërkimore të nevojshme. Ishin vetë udhëheqësit e temave ata që edhe i propozonin këto tema së bashku me studentët, duke qënë njohës të fushës ku studimi do të realizohej. Në këtë mënyrë mendojmë se temat e udhëhequra ishin në bazë të standarteve akademike të kerkuara</p>
<p><b>Standardi III.7 - Institucioni angazhon Përsoneël ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të Përsoneëlit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Stafi ndihmës mesimor-shkencor ishte plotësisht i angazhuar në realizimin e programit. Mbështetja e këtij stafi ishte evidente sidomos në realizimin e praktikave klinike. Personeli ndihmes ishte vazhdimisht prezent në sallat klinike duke mbikëqyrur, kontrolluar dhe koordinuar punën me pacientët. Ky personel ishte gjithashtu Përgjegjës për plotësimin e librezës së studentit ku pasqyrohej egjithë puna klinike e këtij të fundit dhe pa detyrimet e sëcilës, studenti nuk mund të kualifikohet nëlëndën përkatëse. Gjithashtu personeli ndihmës ishte Përgjegjës Për mirëmbajtjen e sallave dhe pajisjen me materialet e nevojshme per realizimin e praktikave klinike. Për të realizuar të gjitha objektivat e programit të studimit në Stomatologji angazhoheshinpërvec stafit akademik edhe Përsoneeli ndihmes mësimor, infermieret e sallave, laborantet, IT, sekretaria mesimore si edhe i gjithë Përsoneeli tjetër administrativ.</p>
<p><b>Standardi III.8 - Përsoneëli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b></p>	

<p><b>Kriteri 1</b> Përsonëli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga Përsonëli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Shpërndarja e ngarkesës mesimore realizohej sipas pedagogëve, në varësi të titujve, të faktit që janë lektorë, ose thjeshtë pedagogë të praktikës, të aftësive profesionale dhe akademike.</p> <p>Ngarkesa mësimore përgatitej nga Departamenti në çdo fillim semestri. Ngarkesa mësimore e secilit pedagog ishte e pasqyruar në plotësimin e regjistrave mësimor, sipas viteve, grupeve të brezave aktiv dhe vlerësohej me ore mesimore. Duhej parë ngarkesa jo e plotë e disa pedagogëve efektivë</p>
--	--

**Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për Përsonëlin e tij.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e Përsonëlit akademik të përfshirë në program dhe të Përsonit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të Përsonëlit akademik, të Përsonëlit ndihmës mësimor-shkencor dhe Përsonëlit administrativ;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e Përsonëlit akademik.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore dispononte dosjen me të dhënat personale të çdo pedagogu të angazhuar në procesin mësimor, sipas viteve akademike.</p> <p>Në Departament depozitohej CV-ja e rinovuar e pedagogëve dhe aktiviteti shkencor personal për çdo vit akademik.</p> <p>Për çdo fillim semestri, përpilohej lista e pedagogëve të angazhuar, krahas ngarkesës mësimore semestrale personale.</p> <p>Vendet vakante shfaqeshin në cdo fillim viti akademik në faqen web <a href="http://www.albanianuniversity.al">www.albanianuniversity.al</a>. Përzgjedhja e kandidatëve kryhej nëpërmjet zbatimit të Rregullores së Brendshme, e cila trajtonte elementet e ndryshme që nga momenti i aplikimit të kandidatit e deri në përmbylljen formale të rekrutimit (kontrata e shkruar), në konform të Kodit të Punës në fuqi dhe akteve ligjore në fuqi.</p> <p>Mendojme se dosja e të dhenave personale ishte në përputhje me standartet shtetërore</p>
--	---

**Konkluzionët e vlerësimit:**

Nga vizita në Institucion u konstatua se :

1. Personeli akademik, personeli ndihmës mësimor-shkencor dhe ai administrativ bashkëpunojnë në përmbushjen e programit dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikules si dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.
2. Rekrutimi i personelit realizohej në varësi të nevojave të paraqitura nga departamenti. Procedura e rekrutimit ishte transparente dhe bazohej në Rregulloren dhe Statutin e Universitetit.
3. Që nga viti 2015, studentëve me mesatare të lartë, me vendim të Këshillit të Fakultetit u jepej mundësia për temë diplome por mendojme se tema duhet dhënë në fillim të vitit të katërt dhe jo në fillim të vitit të pestë për rritjen e cilësive së temës.
4. Zyra e Burimeve Njerëzore dispononte një dokumentacion të saktë në lidhje me të dhenat Personale të Përsonelit të Përfshirë në program, perkundrejt standarteve shtetërore .

**4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Ne konstatuam se institucioni ku kryhej ky program ishte me vendodhje të përhershme në Fakultetin e Shkencave Mjeksore, Rruga e Durresit.

Per realizimin e programit praktik ishte ne dispozicion klinika universitare.

Ne institucion kishte disa salla konferencash te paisura mire me mjetet e nevojshme si kompjutera, videoprojektore, ekrane te medha, disa klasa ku organizohej mesimi me hapsirat e nevojshme dhe mjetet teknologjike perkatese me nje siperfaqe totale 4102m2.

Klinika Universitare, me vendndodhje në godinën e Ish-Gjykatës, është pjesë e rëndësishme e programit të studimit. Ajo ishte e organizuar në salla klinike sipas profileve të programit: salla e terapisë, salla e ortodoncisë; salla e protetikës fikse e të lëvizëshme bashke me laboratorin e studentëve; salla e kirurgjisë ambulatorie; salla e Periodontologjisë dhe e sëmundjeve të mukozave, si dhe një repart imazherie. Sallat ishin të pajisura me aparaturë (unite) bashkëkohore. 84 vende punëishin në dispozicion të punës praktike të studentëve. Sallat ishin të plotesuara me materiale cilësore për punimet në gojën e pacientit. Laboratorëte lëndëve paraklinike ishin të mirë pajisura me mjetet e nevojshme të teknologjisë së viteve të fundit për zhvillimin optimal të praktikave nga ana e studentëve si: mulazhe, 50 fantoma, turbine etj. Mjediset laboratorike shfrytëzoheshin jo vetëm për aktivitetin mësimor, por dhe punë kërkimore shkencore nga ana e pedagogëve dhe studentëve të cilët punonin për temën e diplomës dhe punimet që prezantonin në konferencat studentore. Salla e bibliotekës ndodhej në godinën e ish-gjykatës dhe pasurohej çdo fillim viti akademik, duke u bazuar në kërkesat që buronin nga departamentet dhe nga studentët me literaturë. Deri tani në fondin e bibliotekës të universitetit numëroheshin 1113 libra, që u përkisnin titujve të ndryshëm. Deri në vitin 2015, ishin 117 tituj librash në ndihmë të Departamentit të Stomatologjisë, kurse në 2017, ishin regjistruar 129 tituj, Biblioteka e Fakultetit të Shkencave Mjekësore punonte nga ora 08.00 deri në orën 16.00. Ky orar ishte i shpallur në mjediset e saj. Për çdo student kishte kartelë regjistrimi dhe sigurimi të literaturës, si dhe sistem të kompjuterizuar të shërbimit bibliotekar. I gjithë fondi i bibliotekës ishte i informatizuar. Biblioteka online “Elsevier” ishte një tjetër veçori e infrastrukturës universitare duke mundësuar kështu një zgjerim të gamës së titujve në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve. Në literaturën bazë rekomandoheshin edhe tekste të përkthyer nga shtëpi të ndryshme botuese, si dhe tekste në gjuhë të huaj. Albanian University për plotësimin e kërkesave për tekstet mësimore kishte në dispozicion të pedagogëve dhe ndërmarrjen botuese Albanian University-Press (ish UFO Press) në të cilën ishin botuar të gjithë librat dhe tekstet mësimore për studentët. Zyra e informacionit dhe sekretaria mesimore mundësonte dhenien e çdo informacioni që kërkohet si nga ana e studenteve ashtu dhe Përsonave të tjerë të interesuar, lidhur me programin mësimor, oraret, numrat e klasave etj. Po ashtu ndërtesa ishte e siguruar me roje të cilët shërbenin gjatë të 24 orëve, si dhe ishte e pajisur me sistem kamerash vëzhguese në të gjitha hollat e kateve si dhe në mjedisin e jashtëm. Kanali televiziv UFO Education, pasqyronte të gjithë aktivitetet shkencore-akademike të Departamentit të Stomatologjisë dhe ato në rang Universiteti.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Gjate vizites ne institucion ne konstatuam se egzistonin strukturat qendrore te pershtatshme me standartet si dhe struktura dytesore te mjaftueshme per realizimin e ketij programi

Mjediset për Programin e studimit

- Salla për leksionë 6 (607.2m2)
- Klasa për seminare 4 (206.3 m2)
- Salla për aktivitete promovuese1 (180 m2)
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale16 (1295.6 m2)
- Laboratorë për lëndët 5 (182.6 m2)
- Laboratorë informatike 0
- Salla internëti 1 (49 m2)
- Salla për bibliotekë1 (17 m2)

- Mjedis për fotokopjime, librari etj(28.8 m2)
- Zyrë informacioni për studentët2 (24 m2)
- Nyje hidrosanitare 9 (180 m2)
- Koridore 5 (626.5 m2)
- Mjedise sportive 0

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin 1 (29.4 m2)
- Zyra për sekretarinë mësimore3 (69 m2)
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore2 (35.7 m2)
- Zyra për Përsonein akademik3 (75 m2)

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Institucioni ka vendndodhje të përhershme, ku mjedisi qendror administrativ lokalizohet në adresën: Rruga e Durrësit (ish gjykata e vjetër) dhe mjedisi ku zhvillohet veprimtaria mësimore në adresën: Rruga “Kajo Karafili”, Nr 22, (ish Internacional), Rruga e Durrësit (ish gjykata e vjetër) dhe Rruga e Kavajës (godina e Raifaissen pranë ish Internacional).</p> <p>Mjediset ku realizoheshin këto programe studimi ishin në dispozicion të institucionit për një periudhë mbi 10 vjet. Këto mjedise ishin të arritshme nëpërmjet mjeteve të transportit public dhe privat. Programi i studimit ofrohej në 2 godina të cilat ndodheshin fizikisht afër njëra-tjetrës duke siguruar menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore</p> <p>Programi i studimit “Master i Shkencave në Stomatologji” garantonte kapacitetet e mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale. Ishte respektuar raporti i sipërfaqes me numrin e studenteve.</p>
<b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime Përiodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p>	<p>Tekstet mësimore të vena në dispozicion të këtij program, ishin kryesisht tekste të përkthyer nga stafi akademik i Universitetit. Pasi ishte siguruar leje nga autorët, ishin selektuar traktate cilësore sipas lëndëve përkatëse.</p> <p>Tekstet e përkthyer ishin literaturë amerikane, huazuar nga Universiteti TUFT-s, Amerikë. Biblioteka ishte e plotësuar edhe me tekste mësimore të vetë stafit por mungonin tekstet origjinale të autorëve shqiptarë. E gjithë literatura e sygjeruar nga stafi dhe që përfshihej në program ishte e disponueshme në bibliotekë.</p> <p>Përveçse në bibliotekë, tekstet mësimore studentët mund t'i blenin edhe në librarinë e shkollës. Në dispozicion të studentëve ishte biblioteka online</p>



<p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p>	<p>Elsevier. Aty studentët mund të gjenin botime periodike dhe libra elektronike që përmbanin libra dhe revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit. Përgjegjësi i Departamentit merrte në konsideratë sygjerimet e vazhdueshme të stafit për shtesë në literaturë dhe i përcillte këto kërkesa në rektorat. Biblioteka ishte e hapur nga ora 8.00- 16.00</p>
<p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nëvojat e studentëve.</p>	

**Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p>	<p>Institucioni kishte në sasi të mjaftueshme laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve. Kjo u konfirmua pas vizitës në institucion. Gjithashtu edhe stafi ndihmës si laborantet, teknikët e mirëmbajtjes, IT, asistentët e klinikës si edhe ordinatoret ishin ndihmëse në realizimin e programit.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p>	<p>Sallat e leksioneve ishin me hapësira të mjaftueshme, të pajisura me vende për t'u akomoduar studentët, me videoprojektor, laptop, system audio modern, flipchart dhe tabela. Klasat e seminareve ishin komode, me ndricim dhe me hapësirë. Ato ishin gjithashtu të pajisura me laptop e projektorë. Sallat klinike ofronin 84 unite në të cilat studentët ishin të lire të punonin jo vetëm gjatë orës së mesimit, por edhe në oraret kur poltronat ishin të lirë. Unitet (vendet e punës) ishin bashkëkohore dhe në salla disponoheshin materiale cilësore me të cilat studentët do të realizonin trajtimet e pacientëve të tyre.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p>	<p>Laboratorët e paraklinikës, ishin të pajisur me mulazhe dhe fantoma, të cilat shërbenin për të realizuar programin e kurseve të vitit të parë dhe të dytë. Për pjesën laboratorike të klinikës, përgjigjej laborator i pajisur me të gjitha aparaturat e një laborator bashkëkohor dhe të përshtatshëm për nivelin universitar. Stafi ndihmës mësimor si edhe infermieret e sallës, punonin për të mirëmbajtur mjedisin.</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionësh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Pajisjet e mjediseve mësimore ishin të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit dhe objektivat e tij dhe te pershtaur me plotesimin e standarteve .</p>

**Konkluzionët e vlerësimit:**

Nga vizita në Institucion përsa i përket kapaciteteve infrastrukturore, teknologjike dhe organizative për realizimin e këtij programi ne konstatuam se:

1. Infrastruktura e këtij Universiteti përmban klasa të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike për realizimin e këtij programi në bazë të standarteve të kërkuara.
2. Salla e bibliotekës ishte e mjaftueshme dhe me literaturë profesionale në shqip por duhen shtuar libra të autorëve shqipëtarë
3. Sallat e leksioneve ishin të pajisura me projektor, internet dhe kapacitete të mjaftueshme për realizimin e këtij programi

4. Si strukturat bazë ashtu dhe ato ndihmëse ishin të mjaftueshme, por kërkohet shtimi i numrit të pacientëve në të ardhmen.

## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese. Bazuar në raport si edhe në konstatimet në dokumentacion, burimet financiare të universitetit vinin nga tarifat e shkollimit. Të gjitha të ardhurat nga tarifat e shkollimit shkonin për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e strukturave menaxhuese. Në rang universiteti kishte një njësi e cila merrej me menaxhimin e burimeve financiare si edhe kontrollin e tyre të përmendura më poshtë tek kriteret. Çdo vit buxhetor (për të gjitha vitet e kaluara) zyra përpilonte një raport të hartuar dhe certifikuar nga ekspertë të jashtëm.

Burimet financiare ishin ato që lidhen me tarifat e shkollimit të studentëve. Rreth 1/3 e këtyre burimeve të të ardhurave shpenzohej për qiranë e objektit dhe shërbime të tjera të lidhura me të (mirëmbajtja, pastrimi, ngrohja, ftohja etj). Pjesa tjetër e burimeve të të ardhurave shpenzohej për pagesën dhe sigurimet e punonjësve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe për mbulimin e shpenzimeve që lidheshin me reklamën, internetin, pajisjet e aparaturat, mjetet e konsumit dhe detyrimet ndaj shtetit. Të ardhurat dhe financimet në institucion regjistroheshin, përpunoheshin dhe auditoheshin mbi bazën e një numri unik identifikues (NIPT-i) të lëshuar nga QKR.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

#### (Tabela 11)

- Grantet për kërkim
  - Konsulencat, shërbimet
  - Tarifat për dhe gjatë shkollimit
  - Sponsorizimet
  - Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
  - Donacionët, aktivitetet siguruuese, fondacionë etj
  - Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)
- Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)  
Per sa i perket shpenzimeve per studentet ne konstatuam se atyre u jepeshin libra falas
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të	Institucioni bënte një audit të përvitshëm nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për

<p>ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifatat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>situatën financiare, e cila bëhet mbi bilancin e çdo viti kalendarik.</p> <p>Në RVB nuk ka të dhëna në lidhje me grantet e huaja të Përfituara.</p>
<p><b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenërimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni harton raportin e bilancit të të gjithë shoqërisë çdo vit në të cilin parashikoheshin të dhëna të hollësishme financiare për të ardhurat. Institucioni dëshmonte se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenërimin e të ardhurave në të ardhmen. Aktualisht universiteti nuk përfitonte asnjë grant të huaj. Edhe pse shpenzimet për studentët e stomatologjisë ishin më të larta, në këtë program është investuar fuqishëm për të zgjeruar kapacitetet institucionale dhe cilesinë në infrastrukturë përshtatur me standartet shtetërore</p>
<p><b>Konkluzionët e vlerësimit:</b></p> <p>Nga vizita në Institucion u konstatua se:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Institucioni bënte një audit të përvitshëm nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar për situatën financiare.</li> <li>2. Institucioni dëshmonte se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenërimin e të ardhurave në të ardhmen.</li> <li>3. Investimi në programin “Master të Stomatologjisë” ishte i fuqishëm cka mendojmë se do ta zhvillojë akoma më shumë në të ardhmen.</li> </ol>	

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Në Albanian University, Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë funksiononte që nga viti 2009. Sipas nenit 18 të Statutit të AU, kjo zyrë njihet si një organ i pavarur dhe që ka akses në të gjithë informacionin e kërkuar. Aktualisht ishte ngritur NJSBC e cila përbëhej nga Drejtuesi dhe 5 anëtarë. Në përbërje të kësaj njësie kishte përfaqësues nga departamentet dhe ata referuan gjatë takimit me ekspertët e jashtëm, se nuk kanë hasur vështirësi në marrjen e informacioneve të kërkuara në cdo lloj niveli.

Anëtarët e ZBSC, ishin aktive në plotësimin e detyrave të zyrës. Ata referuan se dy herë në vit, konkretisht në fund të cdo semestri, organizonin pyetësorë me studentët on line. Model

i këtyre pyetësorëve u vu edhe në dispozicion të GVJ. Të dhënat e përpunuara dorëzoheshin tek Rektori, i cili i përcillte problemet e evidentuara në departamente dhe Përgjegjësi i departamenti I diskutonte rezultatet me anëtarët e departamentit. Përcjellja në këtë mënyrë e informacionit, ka ndikuar në evidentimin e problematikave të ndryshme të shprehura nga ana e studentëve (psh: frekuentimi lëndës, komunikimi i pedagogëve, etj). ZBSC përpilonte një raport të vetëvlerësimit në fund të vitit akademik në lidhje me ecurinë e punës, reflektimin mbi problematikat si edhe sygjerimet. Ky raport ishte përpiluar për vitin akademik 2015-2016 dhe ishte në fazën e përpunimit të informacionit për 2016-2017, meqë viti akademik ende nuk kishte përfunduar në kohën kur u kontaktua me GVJ. Zyra organizonte edhe fokus grupet në të cilat merrnin pjesë edhe studentët. Të dhënat e marra përfshiheshin edhe në raportin vjetor të vetëvlerësimit.

Në nivel departamenti, ZBSC në bashkëpunim edhe me Zyrën e Kurrikulave analizonte dhe vleresonte programet mesimore. Zyra kontrollonte gjithashtu edhe raportet semestrale të pedagogëve si edhe rezultatet e studentëve, duke bërë analizën e nivelit të studentëve në vazhdimësi.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Të dhëna Për anëtarët e NJSBC (Aneksi 5)
- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJBSC si:
  - Sa anketime kanë bërë me studentët e programit të studimit: Anketimi zhvillohej në fund të çdo semestri, në total 2 anketime në vit. Kjo ishte aplikuar në mënyrë të rregullt sidomos gjatë dy viteve të fundit.
  - Sa studentë janë anketuar: Ishin anketuar 445 studentë, 92.7 %.
  - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë: Ishin përpunuar të gjitha anketimet, përveç atij të semestrit të dytë për vitin akademik 2016-2017. Problematika e ngritur nga studentët ishte pjesëmarrja e detyrueshme në leksione dhe penalizmi me mungesa në rast mosfrekuentimi.
  - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm: Problematikat e ngritura diskutoheshin në nivel departamenti. Në lidhje me frekuentimin, institucioni ishte treguar i kujdesshëm që të zbatoheshin rregullorja e brendshme dhe pedagogëve u ishte lënë detyrë që studentët vazhdimisht të vireshin në dijeni jo vetëm për zbatimin e rregullores, por edhe për shlyerjen brenda afateve të kërkuara të detyrimeve akademike. Në raste të rralla, gjithmonë sipas asaj që referuan anëtarët e ZBSC, kur kishte patur vërejtje për pedagogët, Përgjegjësi i Departamentit, kishte komunikuar me pedagogun duke përcjellë vërejtjet dhe duke kërkuar përmirësimin e performancës.
- Kontrolli i brendshëm i cilësisë
- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti
- Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre
- Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve Përiodike
- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion: modeli i syllabuseve, modeli i pyetesoreve, "Manifesti Akademik".

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<p><b>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</li> <li>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</li> <li>c. Pyetje konceptuale;</li> <li>d. Intervista;</li> <li>e. Etj.</li> </ul> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionët e rregulluara, etj);</li> <li>b. Dëgjime në auditor;</li> <li>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</li> <li>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</li> <li>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</li> <li>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> <li>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</li> <li>h. Etj.</li> </ul>	<p>Dy herë në vit përpilohej një pyetësor i cili u shpërndahej studentëve dhe plotësohej on-line në mënyrë elektronike. Të dhënat përpunoheshin nga ZSBC dhe përfundimet i përcilleshin Rektorit. Ky i fundit ia përcillte të dhënat departamentit. Nga të dhënat e përcjella në departament, nxirreshin përfundime, të cilat kishin për qëllim kryesisht përmirësimin e punës së stafit akademik dhe administrativ. Në rast vërejtjesh për stafin, ishte tërhequr vëmendja nga Përgjegjësi i Departamentit. Gjithashtu ishte diskutuar edhe në lidhje me cilësinë e studentëve dhe ecurinë e tyre sipas lëndëve.</p> <p>ZBSC të dhënat e marra i përpunonte dhe ia përcillte Rektorit. Në fund të vitit akademik përpilohej një raport i vlerësimit të brendshëm.</p> <p>Ndër metodat e tërthorta që ishin përdorur për vlerësimin e brendshëm përmendim: sondazhe të studentëve që ishin duke ndjekur programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike, apo në ciklet e ndryshme të studimeve, sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit, pyetje konceptuale. Gjithashtu ishin kryer edhe intervista, ishin ngritur here pas here focus grupet.</p> <p>Në metodat e drejtpërdrejta që ishin aplikuar përmendim: dëgjime në auditor, rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pike, rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale, rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit apo punës për përgatitjen e tezës, etj. Në marrjen e këtyre informacioneve kishte ndihmuar sekretaria mësimore.</p>
<p><b>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni publikon rregullisht broshura, buletinë etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Të dhënat në lidhje me vlerësimin e brendshëm vireshin në dispozicion të organeve drejtuese të Institucionit dhe një kopje ruhej pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore.</p> <p>Faqja e internetit të AU është: <a href="http://www.albanianuniversity.edu.al">www.albanianuniversity.edu.al</a></p>

	<p>Në këtë faqe gjetëm të dhëna të përditësuara në lidhje me programet, njoftime të ndryshme apo aktivitete shkencore që institucioni organizonte. Në funksion të publikimit të aktiviteteve është edhe stacionin televiziv Ufo TV.</p>
<p><b>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Analiza vjetore e vlerësimit të brendshëm, përpilohet nga ZBSC për të gjitha nivelet e studimit. Pasi ish në mbledhur të dhenat e cdo fund semestri nga zyra, një raport paraprak i përcillet Rektorit dhe ky i fundit ia përcillet departamenteve. Pas diskutimit në departament, vërejtjet, sygjerimet, etj përfshiheshin në një raport vjetor të vlerësimit, i cili i përcillet Senatit Akademik për të marrë vendimet.</p>
<p><b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e Përsosurëve të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Institucioni është në proces të vlerësimit të jashtëm institucional me kompaninë britanike QAA dhe është në proces riakreditimi për programin “Master i Shkencave në Stomatologji”.</p> <p>Institucioni kishte ngritur prej vitesh ZBSC, e cila funksiononte si një njësi e pavarur, me drejtë të plotë të informimit në cdo nivel dhe me detyrë sigurimin e cilësisë së institucionit.</p> <p>Politika e ZBSC ishte e tillë që informacionet përcilleshin në cdo nivel, në mënyrë që secili të reflektonte për punën e kryer dhe përgjegjësitë. Në këtë mision ZBSC kishte një bashkëpunim të mirë me sekretarinë mësimore si edhe Zyrën e Kurrikulave.</p> <p>Institucioni ka përdorur metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për të mbajtur nën kontroll ecurinë e programeve, vijueshmërinë e studentëve, performancën e pedagogëve, etj.</p> <p>ZBSC ka mbajtur kontakt të vazhdueshëm me personelin akademik dhe studentët. Ajo ka përmbushur një nga detyrat më të rëndësishme të saj që është informimi i stafit dhe i studentëve për sigurimin, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së institucionit.</p> <p>Strategjia për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë ka qënë ndjekja dhe kontrolli i vazhdueshëm në cdo aspekt. Studentëve u është bërë me dije se janë nën kontroll dhe është treguar kujdes në zbatimin e rregullores. Edhe përsa i përket stafit akademik, nga Përgjegjësi i Departamentit në mënyrë të vazhdueshme kanë kryer</p>

kontrolle në lidhje me mësimdhënien, zbatimin e orarit mësimor dhe rregullores së institucionit në përgjithësi. Manifesti Akademik është një publikim i AU, në të cilin u gjetën informacione në lidhje me programet dhe strategjitë e zhvillimit të metëjshëm. Gjithashtu të dhëna të vlerësimit të brendshëm publikohen edhe në faqen e internetit.

**Konkluzionët e vlerësimit:**

1. ZSBC është njësi e strukturuar prej vitesh pranë AU. Ajo përbëhet nga Drejtuesi dhe 5 anëtarë, ndër të cilët, kishte edhe përfaqësues nga departamentet.
2. Zyra ka përdorur metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta për vlerësimin e brendshëm.
3. Informacionet janë përcjellë në cdo nivel dhe në fund të vitit akademik është përcjellë në Senatit Akedemik një raport vjetor i vlerësimit të brendshëm.
4. Strategjia e sigurimit të cilësisë është bazuar në kontrollet e vazhdueshme ndaj studentëve dhe stafit akademik.
5. Të dhëna mbi vetëvlerësimin janë publikuar në faqen e internetit si edhe në “Manifestin Akademik”.

**POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE**

**7. Programi i studimit, organizimi i tij**

**Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit “Masteri i Shkencave në “Stomatologji” ka si mision të tij përgatitjen e mjekëve stomatologë të aftë profesionalisht duke i pajisur ata me njohuri teorike dhe praktike në shërbim të pacientëve. Ky program që nga viti akademik 2009-2010 ka një kohëzgjatje prej pesë (5) vitesh akademike. Kurrikulat e kursit të studimit ishin ndërtuar mbi bazën e Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) me një total prej 300 kreditesh formuese. U konstatua se ishte respektuar norma ku një kredit të jete i barabartë me 25 orë mësimore. Një orë në auditor kishte kohëzgjatje 60 minuta. Në përfundim të ciklit të programit të studimit ishte parashikuar provimi i diplomës, me 10 Kredite (ECTS). Programi në varësi të lëndëve organizohej me leksione, laboratore dhe praktika klinike. Curricula kishte përgjate viteve ndryshime, por duke u respektuar limitet e lejuara, dhe vetem pasi janë miratuar edhe nga Këshilli i Fakultetit të Shkencave Mjekësore.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi
- Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)
  - 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
  - 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
  - 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit

1 orë mësimore = 60' minuta

- Emertimi i diplomes “ Master i Shkencave në Stomatologji”

Në Planët mësimore të jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (Tabela 12)

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

Leksionët 6-12 orë në auditor dhe 19-13orë punë e pavarur e studentit

Seminaret 6-8orë në auditor dhe 19-17 orë punë e pavarur e studentit

Praktikat 18-25orë në auditor dhe 7-0 orë punë e pavarur e studentit

Praktikën Profesionale 20-25 orë në auditor dhe 5-0 orë punë e pavarur e studentit

Planët mësimore të lidhura me Personelin akademik përkatës ( Aneksi 7)

**Ngarkesa mesimore e stafit me kohe te plote (Tabela 13)**

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.Në syllabuset e te gjitha lëndëve ishin te qarte dhe permbanin elementet e meposhtem:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve ( Tabela 14)
- Detyrimet e studentit për lëndën : Pedagogu i lendes ishte i detyruar ne baze te rregullores qe te informonte studentet ne lidhje me programin e lendes, detyrimet vjetore dhe menyren e vleresimit te studentit. Ne rastet e lendeve klinike, studentet pajiseshin edhe me librezen e studentit ne te cilen pasqyroheshin te gjitha punimet e kryera nga studentit.
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse. Në syllabusin e cdo lëndë pershkruhej literatura baze dhe ajo suplementare, megjithate pedagoget ishin te lire qe te shtonin informacione te tjera duke u treguar studenteve burimin e informacionit.

Dokumentacioni përkatës, i marrë në institucion; u vune ne dispozicion te GVJ syllabuset e lendeve, programet e studimit, tabelat me informacionet per PAK, PAE, shperndarjen e ngarkeses sipas pedagoqeve, tabelat me pedagoget qe relizonin programin sipas lendeve specifike, kontrata te pedagoqeve te brendshem dhe te jashtem.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	“Masteri i Shkencave në “Stomatologji” është program studimi i akredituar, me kohë të plotë dhe ka kohëzgjatje prej pesë vitesh akademike, me 300 Kredite në total, kredite sipas Sistemit Europian te Tranferimit te Krediteve (ECTS).
<b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që	



ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Kreditet kishin këtë shpërndarje: 60 Kredite në vitin e parë, 60 Kredite në vitin e dytë, 60 në vitin e tretë, 60 në vitin e katërt dhe 60 Kredite në vitin e pestë, sipas lëndëve të ponderuara.
--	---

**Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.**

<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Në përfundim të programit të studimit “Master i Shkencave në Stomatologji”, studentët kanë marrë njohuritë e duhura të një mjeku stomatolog të përgjithshëm. Programi përfshinte lëndët e formimit bazë si edhe ato të formimit profesional. Kurrikula përfshinte përveç pjesës akademike edhe pjesën e praktikës profesionale.</p> <p>Programi ndërtohej në mënyrë të tillë që gjatë dy viteve të para, kryheshin lëndët e formimit bazë dhe lëndët paraklinike. Në vitet në vazhdim, njohuritë e marra zgjeroheshin në lëndët klinike si edhe konkretizoheshin në punën klinike me pacientët.</p> <p>Të gjithë studentët pas përfundimit të ciklit të studimeve dhe përmbushjen e detyrimeve akademike, pajisen me një diplomë e cila u jep të drejtën e ushtrimit të profesionit.</p> <p>Studentët e këtij programi kishin një hapësirë të madhe për përgatitjen klinike të tyre. U vu re se poltronat shfrytëzoheshin jo vetëm gjatë orës së mësimit. Në cdo moment kur studenti gjente një poltron të lirë, ai mund të punonte me pacientët e tij, nën mbikqyrjen e një pedagogu ose ordinatori. Kjo i favorizon studentët e këtij programi për të fituar manualitet, siguri në punë dhe më shumë eksperiencë për t’u përballur me pacientët pas marrjes së diplomës si dhe për të shlyerë mungesat.</p> <p>Të gjithë studentët që përfundonin programin “Master i Shkencave në Stomatologji” kishin të drejtën që të ndiqnin ciklin e tretë të studimeve, nëse ata i kishin plotësuar kriteret e kërkuara. Kjo u bëhej me dije studentëve gjatë programit të studimit. Nga Zyra e Këshillimit të Karrierës, studentët nxiteshin në kërkimin shkencor si një nga prioritetet për përfshirjen e tyre në programet e ciklit të tretë të studimeve</p>
--	---

**Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.**

<p><b>Kriteri 1</b> Përbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit ishte në përputhje me nivelin e studimeve që ofrohej. Në përfundim të programit cdo student pajisej me njohuritë bazë të një mjeku stomatolog të përgjithshëm</p> <p>Pas përfundimit të cdo lënde, studentët vlerësoheshin me notë. Kjo notë nuk ishte vetëm vlerësimi nga provimi final. Në mënyrë që studenti të ndiqej në vazhdimësi, gjatë vitit akademik, zhvilloheshin modulet, studentët vlerësoheshin me pikë gjatë seminareve, realizonin detyra të ndryshme, merrnin pjesë në aktivitete shkencore duke u përfshirë në punimet e pedagogëve, merrnin vlerësimet për punën klinike me pacientët etj. Këtyre vlerësimeve i shtoheshin edhe pikët e provimit final. Këto pikë konvertoheshin në notë. Në këtë mënyrë studenti ishte vazhdimisht i kontrolluar.</p>
--	--

**Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensionë ndërkombëtare.**

**Kriteri 1** Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane;

**Kriteri 2** Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në metodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;

**Kriteri 3** Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.

Programi i studimit “Master i Shkencave në “Stomatologji” është hartuar mbështetur në kurrikulën e Universitetit TUFT-s, Amerikë.

Programi i studimit “Master i Shkencave në Stomatologji”, pranë AU, përmbante elementet e nevojshëm për një program konkurrues. Programi shtrihet në 5 vite akademike dhe ndërtohet në bazë të ETCS, me një total prej 300 kreditesh. Në fund të programit, diploma e fituar, u jepte të drejtën e ushtrimit të profesionit të gjithë studentëve që i kishin përmbushur detyrimet akademike.

Programi me shtrirjen në kohe, numrin prej 300 kreditesh në total, si edhe sistemin e krediteve të preferueshme, plotëson direktivat e BE-së për arsimin e lartë.

**Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.**

**Kriteri 1** Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;

**Kriteri 2** Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;

**Kriteri 3** Përsonelet akademike angazhohen në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;

**Kriteri 4** Puna kërkimore e Përsoneletit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.

Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.

Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;

Përsonelet akademike angazhohen në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve.

Përgjegjësi i Departamentit luante një rol të rëndësishëm duke e stimuluar vazhdimisht stafin në punën shkencore. Ai organizonte vazhdimisht mbledhje ku informohej në lidhje me aktivitetin shkencor të stafit. Përgjegjësi kishte caktuar një minimum të detyrueshëm prezantimesh, botimesh apo pjesëmarrjesh në aktivitete shkencore. Në këtë mënyrë çdo pedagog ndjehej përpara përgjegjësisë në përmbushjen e këtyre kërkesave dhe nga ana tjetër nxitej fryma e bashkëpunimit ndërmjet kolegëve. Stafit akademik punonte duke përfshirë edhe studentët në punimet shkencore.

Personeli akademik ishte i angazhuar në realizimin e programit si edhe në kërkimin shkencor. Të gjithë pedagogët ishin të detyruar të pasqyronin punën shkencore të tyre në aktivitetet shkencore që vetë institucioni zhvillonte: Konferencën Vjetore si edhe Konferencën Studentore.

**Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.**

**Kriteri 1** Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;

**Kriteri 2** Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:

- mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar;
- kërkesat e punëdhënësve;

Hapja dhe realizimi i këtij programi ka patur si qëllim mbështetjen në zhvillimin e Sistemit Dentar Shëndetësor Shqiptar dhe nevojën e vazhdueshme për përmirësim në këtë drejtim.

Për sa i përket kësaj pike, institucioni ka patur si praktikë, që para se të vendosë hapjen e një programi studimi, të studiojë tregun e punës dhe të bëjë një sërë takimesh me aktorët e interesuar. Para hapjes së programit të studimit “Master i Shkencave në “Stomatologji”, është hetuar tregu i punës dhe është

<p>c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</p> <p>d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionët simotra.</p>	<p>vërejtur se ka nevojë për specialistë të një standarti të lartë të kësaj fushe në tregun shqiptar.</p>
<p><b>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave në “Stomatologji” pranë AU, nuk bie ndesh me interesat kombëtare.</p> <p>Ky Program studimi është hartuar në mënyrë që të sigurojë specialistë të mirëfilltë në fushën e Stomatologjisë, të aftë profesionalisht dhe të pastër moralisht në gjendje për të çuar përpara procesin e zhvillimit dentar e shëndetësor në Shqipëri.</p>
<p><b>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Në programin “Master i Shkencave ne Stomatologji”, informacioni në lidhje me modulet dhe syllabuset është përcjellë në këtë mënyrë: Në fillim të vitit akademik, pedagogu titullar i lëndës, ka konfirmuar pranë Departamentit të Stomatologjisë syllabuset apo programin për lëndën përkatëse. Departamenti pasi ka miratuar programin e lëndës ia ka transmetuar atë Zyrës së Zhvillimit të Kurrikulave. Studentët e kane marrë nga pedagogu i lëndës që në javën e parë orientuese të fillim të vitit akademik, informacionin mbi lëndën, planprogramin, detyrimet akademike të studentit, etj.</p> <p>Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset janë ofruar nëpërmjet sekretarisë mësimore e cila i ka printuar këto informacione për të interesuarit. “Manifestin Akademik”, botim i AU, përmban gjithashtu në mënyrë të përmbledhur programin.</p>
<p><b>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Procesi i diplomimit është konsideruar i përmbushur me kalimin në provimin përfundimtar, ose me anë të mbrojtjes së temës së diplomës. Studentet kane fituar të drejtën për mbrojtje teme, nëse kanë kriteret përzgjedhëse, si mesatare të paktën 8.5, për 4 vitet e mëparshme akademike. Tematikat e diplomimit dhe temat e diplomës janë propozuar dhe miratuar nga Departamenti brenda muajit të parë të fillimit të vitit të 5 akademik.</p> <p>Për realizimin e programit të studimeve “Master i Shkencave në Stomatologji” janë parashikuar 10 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>

### **Konkluzionët e vlerësimit:**

1. Programet e studimit "Master i Shkencave në Stomatologji" ofron një program studimi në përputhje me qëllimin dhe misionin e tij, duke rujtur vlerat kulturore dhe interesat kombëtare.
2. Shtrirja e programit në 5 vite akademike, me një total prej 300 ECTS plotësojnë kriteret e BE-së për arsimin e lartë.
3. Për studentët ishin krijuar të gjitha kushtet për t'u informuar në lidhje me programin.
4. Programi vetëm gjatë 2 viteve të fundit dhe vetëm për studentët me mesatare të lartë ka parashikuar mbrojtjen e diplomës me temë. Sygjerohet që temat nga departamentet të miratohen që në fillim të vitit të katërt akademik, në mënyrë që studenteve t'u lihet më tepër kohë në përgatitjen e një pune kërkimore-shkencore sa më cilësore.

## **8. Mësimdhënia**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësishë etj.

Programi "Master i Shkencave në Stomatologji" shtrihet në 5 vite akademike, përmbante një total prej 300 kreditesh sipas Sistemit Europian të Transferimit të Krediteve. Gjatë dy viteve të para janë zhvilluar kryesisht lëndët e formimit bazë si edhe lëndët paraklinike, kurse në tre vitet e tjera programi plotësohet me lëndët klinike. Mësimi ishte zhvilluar në auditor, salla seminaresh, laboratorët e paraklinikut si edhe sallat e punës së Klinikës Universitare. Sallat ishin të pajisura me kompjuter, videoprojektor, flipchart, me hapësira dhe ndricim. Në përmbushjen e programit kanë marrë pjesë pedagogët efektiv, pedagogët e jashtëm, stafi ndihmës mësimor si edhe ai administrativ. Studentët ishin të ndarë në grupe që evidentoheshin në regjistrat vjetore. Institucioni i njihte këta regjistra si dokumentin zyrtar që evidentonte zhvillimin dhe frekuentimin e lëndës.

Ndër format e aplikuara të mesimdhënies përmendim: leksionet, seminarët, praktikat klinike dhe paraklinike. Studentët janë informuar në lidhje me programin e lëndës që në fillim të vitit akademik, ashtu sikundër edhe me detyrimin e tyre në lidhje me frekuentimin e lëndës. Detyrimet për frekuentimin e lëndës i gjetëm të përshkruara në Rregulloren e Programit të Studimit "Master i Shkencave Mjekesore".

Studentet për lëndët klinike pajiseshin me librezë si një dokument i rëndësishëm ku pasqyrohej puna klinike e studentit me pacientet. Në sallat e lendeve klinike ishin të pasqyruara tabelat me minimumin e detyrueshëm të punimeve klinike që student duhet të realizonte në ato lende.

Vlerësimi final për çdo lende bëhet me note e cila ishte konvertim i pikeve të mbledhura nga provimi final si edhe performance vjetore e studentit: module, përgatitja në seminar, detyra kurse etj.

Studentet ishin pjesë e rëndësishme e vlerësimit të brendshëm, sepse ishin ata që plotësonin në mënyrë anonime dhe on line pyetësoret e përgatitura nga ZBSC.

Pedagoget i kanë përfshirë studentet në punën shkencore. Ata i kanë ndihmuar dhe udhëhequr studentet në prezantimet e tyre gjatë Konferencave Studentore. Studenteve me të mirë u ishte dhënë mundësia e mbrojtjes së diplomës me temë, por kjo është experience vetem e dy viteve të fundit.

## Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies (Tabela 21)

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:
  - Leksionë
  - Seminare
  - Ushtrime
  - Laboratore
  - Praktikë lëndore
  - Praktikë profesionale
  - Etj
- Format e kontrollit të njohurive (Tabela 14)
- Aktivizimi i studentëve në komponëntët e aktivitetit të njësisë etj (Tabela 15)

## 9. Studentët

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Asnje student që kerkonte te regjistrohej për “Master i Shkencave në Stomatologji”, nuk ishte regjistruar nese nuk kishte përfunduar studimet e shkollës së mesme. Procedurat e pranimit te studenteve kane qene si me poshte:

Te interesuarit kane paraqitur këto dokumente: Diplomë e maturës shtetërore së bashku me certifikatën e notave. Për kandidatët që e kishin mbaruar shkollën e mesme jashtë vendit, diploma e shkollës së mesme duhet të ishte e ekuivalentuar pranë Ministrisë të Arsimit dhe të Sportit. Për kandidatët që e kishin përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2011, duhet te dorezonin dëftesën e pjekurie e shkollës së mesme; Fotokopjen e kartës së identitetit, letër njoftimit, ose pasaportës; Fotografi; Formularin e aplikimit.


Për sa i përket procedurave të pranimit, regjistrimit dhe transferimit të studentëve çdo vit akademik institucioni u ishte referuar Udhëzimeve të dala nga Ministria e Arsimit dhe të Sportit, për hapjen e regjistrimeve për fillimin e vitit të ri akademik. Gjate viti te fundit ishte zbatuar udhezimi sipas se cilit duheshin regjistruar në kete program vetem studente me mesatare mbi 6. Mesatarja e shkolles se mesme nuk kishte qenë kriter me heret për pranimin e studenteve.

Cilësia e studentëve në hyrje, në përgjithësi ka qene mesatare. Nota mesatare në hyrje që prej vitit 2010-2015, ka qene mesatarisht 8.35. Per te terhequr studente cilesore, institucioni ka aplikuar tarifa te reduktuara.

Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë në vitin e parë (viti akademik 2010-2011) është 133 dhe prej tyre janë diplomuar 163 studentë. Rritja e numrit të studentëve të diplomuar në brezin 2010-2015, shpjegohet me numrin e studentëve të transferuar nga universitetet e mbyllura.

Brezi 2011-2016 janë regjistruar 104 në vitin e parë për herë të parë.

Brezi 2012-2017 janë regjistruar për herë të parë në vitin e parë 69 studentë.



Brezi 2013-2018 janë regjistruar për herë të parë në vit të parë 52 studentë.

Brezi 2014-2019 janë regjistruar për herë të parë në vitin e parë 77 studentë.

Për vitin akademik 2015-2016 janë regjistruar për herë të parë, 57 studentë.

**Aktualisht ne regjistrat e AU ne lidhje me numrin aktual te studenteve ne kete program per vitin akademik 2016-2017, morren keto te dhena:**

**Ne vitin e pare jane te regjistruar 63 studente.**

**Ne vitin e dyte jane te regjistruar 59 studente.**

**Ne vitin e trete jane te regjistruar 77 studente.**

**Ne vitin e katert jane te regjistruar 74 studente.**

**Ne vitin e peste jane te regjistruar 102 studente.**

**Totali: 375 studente.**

Studimet në programin “Master i Shkencave në “Stomatologji” zgjasin 5 vite akademike te ndare në 10 semestra.

Kalueshmëria e studentëve nuk lidhej vetem me faktin se cfare vleresimi final kishte marre student në provimin final te lëndës, por edhe me përmbushjen e të gjithë detyrimeve për të frekuentuar ate lëndë.

Studentëve u ishin ofruar mundesite qe te informoheshin në vazhdimësi për kalendarin akademik, për periudhën e provimeve të pjesshme, për sezonet e provimeve, për çdo element që ka patur lidhje direkte me mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Departamenti ka ruajtur te dhenat e studenteve te brezave te meparshem dhe ka komunikuar me ta në menyre qe te informoheshin në lidhje me punësimin dhe edukimin në vazhdimësi te tyre. Studenteve me te mire u ishte krijuar mundesia e përfshirjes në program si ordinatorë apo asistente pedagoge.

**Vlerësimi i Tregues të matshëm:**

- Procedurat e pranimit të studentëve. Studentet jane pranuar me dosje duke respektuar udhezimet e MASH.
- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 16)
- Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë) (Tabela 16)

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nga të dhënat e marra pranë sekretarisë mësimore në vitin akademik 2010-2011 janë regjistruar për herë të parë 133 studentë me një mesatare hyrëse 8.00. Numri të diplomuarve të këtij brezi ishte 157 me një mesatare dalje 6.8. Rritja e numrit të të diplomuarve erdhi si pasojë e transferimeve nga IAL-të e mbyllura. Nga 133 studentët e regjistruar për herë të parë, i përfunduan studimet pa vite përsëritëse 85 prej tyre.

- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend (Tabela 17)
- Të dhëna për punësimin e studentëve
- Numri total të diplomuarve; brezi 2011-2016 jane 130 studente (Tabela 18)
- Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën); per periudhen 2011-2015 plus 2016 jane 655 te punesuar.(Tabela 18)

- Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën); per periudhen 2011-2015 plus 2016 jane 329 te punesuar.(Tabela 18)

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton planë të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Studentët që ishin regjistruar në këte program kanë qenë të pajisur me diplomë të shkollës së mesme si kusht për të hyrë në një program të integruar.</p> <p>Pranimi në këtë program studimi është bërë në përputhje dhe në zbatim të Ligjit 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi.</p> <p>Për t'u regjistruar në programin "Master i Shkencave në "Stomatologji", studentët i janë përgjigjur kriterëve dhe modaliteteve të publikuara në Shpalljen Zyrtare të Pranimeve.</p> <p>Institucioni i ka informuar të gjithë studentët e programit të studimit "Master i Shkencave ne Stomatologji" të cilët janë regjistruar për herë të parë në vitin akademik 2010-2011 e në vitet akademike në vijim, se e kanë si detyrim ligjor mbrojtjen e gjuhës angleze para diplomimit.</p> <p>Kriteret e pranimit ishin përcaktuar në fillim të cdo viti akademik duke respektuar udhëzimet e ardhura nga MASH.</p>
<b>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Institucioni nëpërmjet faqes së internetit cdo fillim viti shpallte vendet vakante për punësim pranë tij. "Udhëzuesi për zhvillimin e karrierës" ishte një manual që u ishte dhënë të diplomuarve në mënyrë që ata vetë të kuptonin se si mund të punësoheshin dhe të kishin një performancë sa më pozitive.</p> <p>Studentëve u ishte bërë me dije vazhdimësia dhe rezultatet e procesit të akreditimit të institucionit dhe programeve të ndryshme që ai ofronte.</p> <p>Ka funksionuar pranë AU Zyra e Këshillimit të Karrierës. Ajo është marrë me përpilimin e manualit "Udhëzuesi për zhvillimin e karrierës" dhe ka ruajtur kontaktet me studentët e diplomuar, sidomos me ata më cilësore, të cilëve u ishte krijuar mundësia për punësim pranë AU.</p>

<b>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Në sekretarinë mësimore u gjetën të dhëna në lidhje me numrin e studentëve të diplomuar në vite.</p> <p>Në regjistrat themeltarë, të depozituar pranë sekretarisë mësimore, gjetëm të dhëna mbi numrin e studentëve të regjistruar, për tërheqjet nga programi, mospërfundimin e vitit akademik, transferimet nga IAL-të e tjera.</p> <p>Për të gjithë studentët e regjistruar për herë të parë pranë këtij programi, si edhe për atë transferuar nga IAL-të e tjera, u vu re se ishin pasquruar të dhënat në lidhje me vlerësimin e studentëve në vazhdimësi duke u reflektuar me “notë”, nuk kualifikohet” ose “njohur” për kreditet e transferuara.</p>
<b>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>AU ka ruajtur kontaktet me te diplomuarit. Te dhenat e punesimit te tyre sipas profilit jane konfirmuar nga Institucioni i Urdherit te Stomatologut.</p> <p>Institucioni ka ruajtur te dhenat ne lidhje me studentet qe kane vazhduar ciklin e trete te studimeve brenda institucionit, jashte institucionit dhe jashte Shqiperise.</p>
<b>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Studentet e kane marre informacionin e pare gjate javes orientuese në vitin e pare. Me pas ka qene Zyra e Keshillimit e cila kishte mbajtur vazhdimisht te infromuar studentet në lidhje me vazhdimësinë e studimeve, procesin e akreditimit etj. Pedagoget kane qene pjese e ketij informimi gjithashtu.</p> <p>Si gjatë ashtu edhe në përfundim të programit të studimit në “Stomatologji” studentët kanë patur mundesine e informimit në lidhje me rezultatet e vlerësimit nepermjet sekretarise mesimore. Aktualisht u informuam se po punohej per nje info “on line” ku studentet në menyre elektronike mund te informoheshin në lidhje me rezultatet e provimeve.</p> <p>Pedagogu i lendes pasi kishte perfunduar vleresimin final te studentit, ka qene i detyruar qe te ballafaqoje porvimin me studentin në rast se ky i fundit nuk ka qene dakord me vleresimin e marre.</p>
<b>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon Përsosëlin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b>	



<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Departamenti i Stomatologjisë ka qene ndërmjetësi i studentëve me Dekanatin dhe Rektoratin, për zgjidhjen e problemeve të ndryshme. Përgjegjesi i departamentit ka ndjekur dhe kontrolluar ecurinë e studenteve dhe është marre me zgjidhjen e problemeve të hasura gjate programit. Zyra e Këshillimit të Karrierës, i ka orientuar të diplomuarit në tregun e punës, me anë të informimit të vendeve të lira, si dhe ndihmesës në aplikimin për punësim, duke ndërmjetësuar procesin mes punëdhënësve potencialë dhe studentëve.</p>
<p><b>Konkluzionët e vlerësimit:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Procedurat e rekrutimit të studentëve janë zbatuar në varësi të kapaciteteve akademike, të infrastrukturës si edhe udhëzimeve të MASH. Gjatë vizitës pranë sekretarisë mësimore u krye një kontroll i rastësishëm në mesataren e studentëve të rekrutuar gjatë vitit akademik 2016-2017 dhe u vu re se është zbatuar udhëzimi i MASH sipas të cilit mesatarja e studentit në hyrje të studimeve duhet të ishte mbi 6.</li> <li>2. Institucioni kishte regjistra të rregullt në lidhje me vlerësimet në vazhdimësi të studentit, transferimet apo detyrimet e prapambetura.</li> <li>3. Studentët ishin të informuar mbi zhvillimin e programit dhe procesin e akreditimit.</li> <li>4. Zyra e Këshillimit të Karrierës ka mbajtur kontakte me të diplomuarit dhe i kishte informuar në lidhje me tregun e punës, vendet vakante në institucion, si dhe kishte asistuar në aplikimet e tyre në institucione të tjera. Udhëzuesi i Karrierës, një manual i botuar nga AU u ishte ofruar të diplomuarve si një ndihme në fillimin e karrierës së tyre.</li> <li>5. Studentët më të mirë kanë patur mundësinë të punësohen menjëherë pas përfundimit të studimeve pranë AU në administratë apo në ndihmë të procesit mësimor. Departamenti mbante kontakte me të diplomuarit dhe dispononte të dhëna në lidhje me punësimin e tyre.</li> </ol>	

## KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

### 10. Kërkimi shkencor

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

AU kishte treguar kujdes edhe në hartimin e politikave të kërkimit shkencor. Për të stimuluar punën shkencore, Përgjegjësi i Departamentit kishte vendosur një minimum punimesh shkencore (prezantime , botime) si edhe pjesëmarrjeje në aktivitetet shkencore për të gjithë pedagoget efektiv të departamentit. Vetë institucioni kishte investuar duke organizuar çdo vit Konferencën Shkencore Stomatologjike si edhe Konferencën Studentore. Në keto aktivitete stafi akademik kishte pasqyruar kërkimin shkencor përgjatë vitit. Në prezantimet e studentëve bashkëpunëtorët kryesorë kanë qënë pedagogët. Duke i diskutuar këto punime gjatë seminareve apo orëve praktike, ata kanë ndërthurur procesin mësimor me atë shkencor. Revista "Optime", organi i AU, me ISBN 2220461X, është një hapësirë që institucioni kishte krijuar për të publikuar punimet shkencore të stafit të brendshëm, por jo vetëm. Për të rritur cilësinë e punimeve shkencore, ishin përfshirë në aktivitetet e ndryshme edhe pedagogë të huaj nga institucionet me të cilat AU ka kontrata bashkëpunimi.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:



- Të dhëna për kërkimin shkencor (Tabela 19)
- Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda iAL
- Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor
- Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor
- Numri i Çmimeve Kombëtare
- Dokumentacioni përkatës i marrë gjatë vizitave. U shfrytëzuan të dhenat e vena në dispozicion nga departamenti, si edhe nga kontrolli i rastesishëm i dosjeve të pedagogëve.

### **Vlerësimi sipas Standardeve**

<b>Standardi/Kriteret</b>	<b>Vlerësimi sipas standardeve</b>
<b>Standardi III.3 - Përsoneili akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përsoneili akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Përsoneili akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Personeli akademik ishte i përfshirë në kërkimin shkencor duke respektuar apo tejkaluar një minimum punimesh shkencore apo pjesëmarrjeje të detyruar vjetore në aktivitete shkencore, gjë që kontrollohej nga përgjegjesi i departamentit. Vetë institucioni kishte krijuar kushtet për prezantimin e punimeve shkencore apo publikimin e punës së kryer nga stafi apo studentët nëpërmjet organizimit të konferencave dhe Revistës "Optime".</p> <p>Në një pjesë të mirë të punimeve shkencore ishte vënë re bashkëpunimi me pedagogët të huaj, duke ndihmuar në njohjen dhe implementimin e metodave të reja terapeutike.</p>
<b>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një Përsoneil akademik të kualifikuar.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përsoneili akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Përsoneili akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Mësimdhënia në Departamentin e Stomatologjisë kryhej vetëm në gjuhën shqipe.</p>
<b>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të Përsoneilit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të Përsoneilit akademik e të Përsoneilit mësimorshkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni u ofron Përsoneilit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Departamenti kishte ftuar pedagogë të huaj nga institucionet me të cilat ka marrëveshje dhe ka organizuar seminare apo leksione të hapura me studentët dhe stafin. Departamenti i Stomatologjisë i cili është përgjegjës për programin "Master i Shkencave në Stomatologji", ofronte gjithashtu edhe programe të ciklit të tretë të studimeve. Nuk kishte të dhëna në lidhje me mobilitetin e studentëve apo stafit akademik jashtë vendit.</p>
<b>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të Përsoneilit akademik të tij.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të Përsoneilit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p>	<p>Departamenti mbante dosjet e perditesuara te aktivitetit shkencor te stafit. Akademik.Gjate vizites në institucion u kontrolluan në menyre te rastesishme disa dosje te personelit akademik. U vu re se dosjet ishin te përditesuara në lidhje me aktivitetin shkencor.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të Përsoneilit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p>	<p>Ne dosje ishin te depozituara botimet, prezantimet brenda dhe jashte vendit si edhe pjesemarrjet ne aktivitet shkencore. Prane departamentit kishte edhe te dhena ne lidhje me projektet ne te cilat ishte perfshire edhe stafi akademik.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë Përsoneili akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	
<p><b><u>Konkluzionët e vlerësimit</u></b></p> <p>1. Personeli akdemik pranë Departamentit të Stomatologjisë kishte treguar përkushtim për punën dhe kërkimin shkencor. Të dhënat mbi aktivitetin shkencor për secilin pedagog ishin të depozituara në departament. Nga kontrolli i rastësishëm i dosjeve u vu re se ato ishin të rregullta dhe të përditësuar.</p> <p>2. Institucioni ishte angazhuar në kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të stafit. Vetë institucioni ka organizuar konferenca të përvitshme si dhe ka vënë në dispozicion Revistën “Optime”, duke krijuar mundësinë e pasqyrimin të punës kërkimore shkencore të stafit.</p>	

## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** bashkëpunimi me institucionët e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i Përsoneilit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.


Albanian University ka marrëveshje me Institucione Kombëtare dhe Ndërkombëtare. Marrëveshjet e bashkëpunimit ishin negociuar nga Institucioni dhe ishin nënshkruar nga Dekani i Fakultetit, ose nga Rektori. I gjithë programi realizohej në gjuhën shqipe dhe stafi akademik i përfshirë në program, nuk kishte pedagogë të huaj. Nuk ka të dhëna për mobilitetin e stafit apo studentëve jashtë shtetit në institucionet me të cilat janë nënshkruar marrëveshjet. Bashkëpunimi është fokusuar në organizime të përbashkëta të aktiviteteve shkencore.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (Tabela 19)
- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionët e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Tabela 20)
- Dokumentacioni përkatës. Ne viziten e kryer ne institucion na u vune ne dispozicion disa marreveshje bashkepunimi.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<p><b>Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.</b></p>	



<p><b>Kriteri 1</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve "Master Profesional", institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve "Master i Shkencave" ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitim të njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Institucioni ka marrëdhënie dhe marrëveshje institucionale me institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, publike apo private. Bashkëpunimet me institucionet arsimore jashtë vendit janë konkretizuar në 2 Konferencat Internacionale gjate dy viteve të fundit si edhe një e tretë që po përgatitet për t'u zhvilluar këto shtator. Me heret, ky bashkëpunim ishte konkretizuar me pjesëmarrjen si lektore të pedagogëve të huaj në aktivitetet që AU ka organizuar. Edhe pse në kontratat parashikohet shkëmbim i stafit dhe i studenteve nuk u gjeten faket që të konkretizojnë këto pike të marrëveshjes. Nga ana tjetër, AU ka në respektim të marrëveshjeve me OJF, ka kryer shërbime dentare falas për shtetasit në nevojë, viktimat e dhunës në familje apo trafikut. Në bashkëpunim me biznesin, AU ka vënë në dispozicion ambientet e tij duke ndihmuar në ndërmjetësimin e punësimit në Gjermani.</p>
<p><b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes Përsoneit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet Përsoneit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes Përsoneit brenda institucionit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>AU ka respektuar marrëveshjet e bashkëpunimit. Shembuj të këtij bashkëpunimi u përmenden me sipër. Vazhdimësia e këtyre aktivitetëve, është tregues i seriozitetit nga ky institucion.</p>
<p><b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimëve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Gjate vizites në institucion u vënë në dispozicion marrëveshjet e bashkëpunimit. Në këto marrëveshje përfshihen bashkëpunimi i AU me institucione homologe jashtë vendit (Universiteti i L'Aquillas, Itali; Fakulteti i Mjekësisë Dentare "Carol da Vila", Rumani; Rrjeti i Universiteteve "Mediterranean Middle West Network", Napoli, Itali), por mungonin marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet homologe brenda vendit. Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me OJF ("Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit", "Organizata të ndryshme dhe Të Barabartë", "Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të dhunës në Familje") si edhe me komunitetin e biznesit ("Qendra e Formimit Profesional Ilingua"). Nga këto marrëveshje institucioni kishte përfituar shkëmbin e experiences së stafit akademik nëpërmjet organizimeve shkencore si edhe përfshirjen e këtyre pedagogëve të huaj në jetën akademike të institucionit, por jo në këto programe.</p>

**Konkluzionët e vlerësimit:**

1. Institucioni ka patur marrëdhënie bashkëpunimi me intitucione të tjera homologe jashtë vendit, aktorët e biznesit, si edhe OJF.
2. Marrëveshjet ishin nënshkruar nga Dekani i Fakultetit ose Rektori. Të dy palët përcaktoun pikat e bashkëpunimit dhe impenjoheshin në zbatimin e tyre.
3. Përfitimi konkret nga bashkëpunimi me institucionet homologe të huaja ka qënë organizimi i përbashkët i aktiviteteve shkencore si edhe shfrytëzimi i experiencës akademike të lektorëve të huaj.
3. Mungonin të dhëna mbi shkëmbimin e stafit akademik dhe studentëve për të konkretizuar marrëveshjet bilaterale.
4. Mungonin marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e tjera homologe në vend

**ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT****I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË**


Institucioni ka punuar për plotësimin e rekomandimeve nga akreditimi i parë. Që nga viti 2010, programi “Master i Shkencave në Stomatologji”, shtrihet në 5 vite akademike, përmban 300 kredite sipas Sistemit European të Transferimit të Krediteve.

Është punuar mirë në zgjerimin e infrastrukturës dhe rritjen e numrit të poltronëve, duke përmirësuar raportin e sipërfaqes për student. Nga 60 vende pune tani janë në dispozicion të studentëve 84 të tillë dhe nga 3 salla klinike më parë, tani janë 6 të tilla.

Është reflektuar në zvogëlimin e numrit të studenteve për grup. Grupet mësimore organizohen me nga 18-22 studentë.

**II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).****a. Pika të forta:**

- 1) Institucioni ishte konceptuar sipas një infrastrukture ku respektoheshin të gjitha nevojat Për mbarëvajtjen e programit, kishte salla të bollshme. Për realizimin e seminareve dhe leksioneve, te pajisura me mjete bashkekohore. Klinika Universitare si pjese e kesaj infrastukture ishte mjaft e rendesishme në nderthurjen e teorise me praktiken profesionale. Janë konceptuar mirë nevojat për sekretarinë mësimore, bibliotekën, zyrat për administratën etj.
- 2) Programi mësimor ishte i ndërtuar sipas të gjithë parametrave të kerkuar. Në syllabuset e lëndëve pasqyroheshin qartë tematikat, mënyrat e organizimit të lëndës e deri tek mënyra e vlerësimit të studentit.
- 3) Literatura e vënë në dispozicion të programit ishte bashkëkohore, pasuroheshin vazhdimisht me tituj të rinj, dhe mbi të gjitha pjesa më e madhe ishte e përkthyer në shqip, pasi ishte siguruar leja e autorit.
- 4) Stimulimi dhe ndihma që institucioni jepte në ngritjen profesionale të stafit, duke organizuar konferenca shkencore të paktën dy herë në vit



**b. Pika të dobëta:**

- 1) Duhet punuar në rekrutimin e stafit me tituj akademikë. Mjaft nga Personeli i kategorisë "Profesor" ishte afër moshës së pensionit ose e kishte mbushur atë
- 2) Duhet punuar më shume në plotesimin e marrëveshjeve bilaterale në të cilat parashikohet edhe shkëmbimimi i stafit akademik dhe studentëve

**c. Mundësitë:**

- 1) Përfshirja në program edhe e pedagogeve të huaj nga institucionet me të cilat kanë marrëveshje bashkëpunimi mund t'a bëjë edhe me atraktiv këtë program.
- 2) Rritja e kapaciteteve të Klinikës Universitare, do të krijojë mundësinë e tërheqjes së një numri më të madh pacientësh të cilët mund të trajtohen nga studentët, pra një mundësi për të stimuluar regjistrimin në këtë program i cili do të ofrojë më shumë praktikë profesionale

**d. Pengesat:**

- 1) Vështirësi në rekrutimin e Personelit akademik me tituj dhe grada
- 2) Tregu i pa kontrolluar i punës pas një dekade me një numër shumë të madh studentësh të diplomuar

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm**

1. Prof. Ramazan Isufi
2. Prof. Asoc. Çeljana Toti

**SUMMARY ANALYSIS OF SUPPLEMENTING OF RECOMMENDATIONS FROM THE FIRST ACCREDITATION**

The institution had been engaged to comply with the recommendations from the first accreditation. Since 2010, the "Master of Science in Dentistry" program is extended to 5 academic years, containing 300 credits according to the European Credit Transfer System. There was much work done to expand the infrastructure and to increase the number of dental chairs, improving the student/surface ratio. During the first accreditation process there were only 60 dental chairs and only 3 clinical rooms. Now there are 84 clinical chairs and 6 clinical rooms

The number of student per group has been decreased. Student groups are organized with 18-22 students.

**SUMMARY ANALYSIS OF THE PERIODIC EXTERNAL EVALUATION (PEE) BY SWOT METHOD (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS).**

**a. Strengths:**

- 1) Infrastructure. The institution was conceived according to an infrastructure where all needs were respected. There were rooms equipped with contemporary tools for the

implementation of the clinical and theoretical program. The University Dental Clinic as part of this infrastructure was very important in combining theory with professional practice. Well-designed needs are well conceived for the secretary, library, administration offices as well as the sanitary hygiene nodes.

- 2) The curriculum was developed according to the required parameters. The syllabuses clearly reflected the topics, the ways of organizing the course (theoretical & practical) up to the student's assessment.
- 3) The literature provided by the program was contemporary, enriched constantly with new titles, and most of them were translated in albanian after the author's permission was obtained.
- 4) The institution promotes and supports the process of continuing education by organizing scientific conferences at least twice a year.

**b. Weaknesses:**

- 1) It is necessary to work on recruiting staff with academic titles. Many of the "Professor" category staff were close to or had filled the retirement age.
- 2) More work needs to be done in complementing bilateral agreements whereby the exchange of academic staff and students is foreseen

**c. Opportunities:**

- 1) Inclusion of invited academic staff from the foreign institutions based on the cooperation agreements can make this program more attractive.
- 2) Increasing the capacities of the University Dental Clinic, will raise the number of patients treated by students, which will attract more students registrations in this program.

**d. Threats:**

- 1) Difficulty in recruiting new staff with academic titles and degrees.
- 2) Uncontrolled labor market after a decade with a large number of graduated students.

External evaluation group

Prof. Ramazan Isufi

Prof. Asoc. Çeljana Toti